



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality of Rahovec



Mbështetur në Ligjin Vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040, neni 14,pika 14.2, Ligjin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Statutit të komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017, Neni 18 pika 3 të Rregullores për Taksa komunale 01/80, vendimit të Kuvendit Komunal të Rahovecit, 01 Nr.107 të datës: 31.07.2023 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës së Rahovecit.Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës i caktuar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit nr.108, të DT. 31.7.2023, shpall këtë;

NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK

PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR

1. Njoftimi publik për dhënien e pronave të paluajtshme në pronësi të Komunës, përmban si në vijim:

1.1 Prona komunale në fshatin Xërxe , ngastra kadastrale nr. P-71510033-01036-2, zona kadastrale në Xërxe, në vendin e quajtur e quajtur Suga kod puta, arë e klasës 4, në sipërfaqe prej 2445 m² (dy mijë e katërqind e dyzet e pesë metra katrorë) dhe në shfrytëzim do të jepet sipërfaqja prej 1600 m² (njëmijë e gjashtëqind metra katror).

1.2 Prona komunale në fshatin Xërxe , ngastra kadastra le nr. P-71510033-01033-2, zona kadastrale në Xërxe, në vendin e quajtur e quajtur Skaja, arë e klasës 3, në sipërfaqe prej 2161 m² (dy mijë e njëqin e gjashtëdhjet e dy metra katrorë) dhe në shfrytëzim do të jepet sipërfaqja prej 1900 m² (njëmijë e nëntëqind metra katror).

Njoftimi për ankand publik përfshinë:

1.1. Çmimin fillestar i pronave komunale-hapësirat e jashtme që është objekt i dhënies në shfrytëzim përmes ankandit publik:

- Çmimi fillestar për dhënien e pronave në shfrytëzim – **pronat komunale në fshatin Xërxe** do të jetë **0.15 €/m²**.

1.2. Afati i dhënies në shfrytëzim i pronave:

Afati i dhënies në shfrytëzim të pronave së paluajtshme të Komunës – **pronat komunale në fshatin Xërxe** do të jetë afatshkurtër prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh.

1.3. Veprimtaria që ushtrohet sipas de stinimit të pronës:

Pronat komunale e dhënë në shfrytëzim – hapësirat e jashtme te rezervat shtetërore në fshatin Xërxe do të shërbej për **zhvillimin e aktivitetit biznesor**

1.4. Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik dhe data e fundit e dorëzimit të ofertave:

Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik për dhënien e pronave për shfrytëzim afatshkurtër është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Komunës, në vendet publike, elektronike dhe të shkruara. Ofertat dorëzohen të mbyllura nëpërmjet zyrës së prokurimit në Rahovec nga data: **5.10. deri me datë: 19.10.2023 , nga ora 09:00 deri në ora 15:00.**

Vendi, koha ku do të mbahet ankandi publik:

Në sallën e Kuvendit Komunal me dt. **23.10.2023** në fillim në ora **13:30**, do të bëhet hapja e ofertave të mbyllura dhe të njëjtat do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në ankand publik.

1.5. Kushtet apo kufizimet mbi dhënien e të drejtave për shfrytëzim:

- 1.5.1. Pronat nuk mund të përdorën për qëllime tjera përpos siç është përcaktuar me ankand publik dhe e njëjta nuk mund të bartet ne personin e tretë.**

2. Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në ankand publik:

2.1. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik,

2.2. Personat fizik krahas aplikacionit në kuvertë duhet të ofrojnë edhe kopjen e letërnjoftimit dhe dëshminë mbi pagesën e tatimit në pronë

2.3. Vërtetimin nga ATK-ja

2.4. Deklarata nën betim(ky dokument është aneks i dosjes)

2.5. Personat juridik, krahas aplikacionit në kuvertë duhet ta bashkëngjisnin

- a. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me informata mbi biznesin.
- b. Vërtetimin e taksës komunale në afarizëm,
- c. Vërtetimin nga Administrata Tatimore e cila ka afatesh mëri.
- d. Deklarata nën betim (ky dokument është aneks i dosjes).

3. Kriteret për aplikim:

4. Oferta ekonomikisht më e favorshme

- 4.1.Çmimi me i lart i qeras mujore.....40 pikë
- 4.2. Aktiviteti bujqësor10 pikë
- 5.5.Shtimi i numrit të punëtorëve të rinj, max10 pikë
- 4.6. Projekti investiv për 15 vite..... 40 pikë

3.1. Pjesëmarrësve në konkurrim iu garantohet e drejta që të:

- 3.1.1. Informohen lidhur me procedurat e ankandit publik,
- 3.1.2. Shohin pronën që do të jepet në shfrytëzim,
- 3.1.3. Kanë qasje në dokumentacionet e pronës,
- 3.1.4. Tërhiqen nga ankandi jo më vonë se tre (3) ditë para mbajtjes së ankandit publik.
- 3.1.5. Fituesi duhet të nënshkruaj regjistrin e procedurës së ankandit publik. Nëse informatat e dhëna nga ofertuesi dëshmojnë si të pasakta, komisioni ka të drejtën që të refuzojë dhënien e pronës në shfrytëzim.
- 3.1.6.

4. Raporti i vlerësimit të ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës:

- 4.1. Komisioni vlerësues brenda tri (3) ditë pune nga përfundimi i vlerësimit të ofertave në ankand publik, harton raportin përfundimtar për përmbylljen e ankandit publik për

dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

4.2. Raporti përfundimtar i Komisionit vlerësues të ofertave të ankandit publik përmban:

- 4.2.1. Një kopje të shpalljes së ankandit publik;
 - 4.2.2. Procesverbalin e procesit të ankandit publik;
 - 4.2.3. Rekomandimin e Komisionit për zgjedhjen e fituesit;
 - 4.2.4. Një kopje të protokolluar të ofertës së përzgjedhur;
 - 4.2.5. Ankesat e parashtruara nga pjesëmarrësit në ankand publik.
5. Pas miratimit të ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues, njoftimi i dërgohet fituesit dhe i njëjti publikohet në tabelën e shpalljeve dhe në ueb - faqen e Komunës. Ofertuesi me çmimin më të lartë të ofruar në pliko të mbyllura do të shpallet fitues gjatë procesit të hapjes së ofertave.
6. **Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtojë ankesë pranë komisionit për vlerësimin e ankesave në afat prej shtatë (7) ditësh.**
7. Nëse Komisioni i ankesave konstaton se ka shkelje gjatë procesit të vlerësimit ka të drejtë të kërkojë rishqyrtimin e procesit, por nëse komisioni i ankesave vlerëson se nuk ka bazë, atëherë ankesën e refuzon si të pabazuar.
8. Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, nënshkruhet nga Kryetari i komunës dhe fituesi i zgjedhur, brenda 15 ditësh pune nga data e miratimit të ofertës nga ana e Komisionit vlerësues.

Vërejtje: Tërheqja e aplikacioneve për konkurrim në ankand publik bëhet në formë fizike në zyrën e prokurimit në Rahovec.

Rahovec, 4.10.2023

Komisioni vlerësues i Ofertave